



## e-Pjesëmarrje

*Merr pjesë dhe ti në vendim-marrje duke përdorur shërbimet e Teknologjisë së Informacionit !*



## Axhenda WEB.DEP Shqipëri

- *Takim i grupeve te interesit institucione-NGO-eksperte*  
Janar 2009
- *Takimi i Gazetareve shqiptare te perfshire ne kete nisme*  
Shkurt 2009
- *Publicitet / marketing i programit ne mediat shqiptare e forumet e komunikimit online*  
Shkurt-Mars 2009

## WEB.DEP - Workshop Kombëtar në Shqipëri

### Info....

Workshopi ATSH-WEB.DEP u zhvillua në Hotel Tirana Internacional ne Shqipëri më 23 Tetor 2008 dhe ishte aktiviteti më i rëndësishëm i paraqitjes në publik.

### Objektivat

#### Sesioni i parë – Konferencë për Media Publicitet i Projektit

- Informimi i pjesëmarrësëve në mënyrë të veçantë mediat mbi projektin WEB.DEP duke prezantuar objektivat dhe rezultatet e arritura nga ATSH-WEB.DEP.
- Terheqja e vëmendjes së gazetarëve, medias shqiptare dhe aktorëve potencial për tu bërë pjesë e iniciativës WEB.DEP.
- Promovimi i WEB.DEP në një public të gjerë shqiptar nëpërmjet TV, gazetave, Radio etj...



### Pjesëmarrësit

Më 23 Tetor, 2008 Tiranë Konferenca WEB.DEP mblodhi rreth 70 pjesëmarrës, të cilët përfaqësonin shumë organizata shqiptare të interesuara për projektin WEB.DEP.

#### Sesioni i dytë – Ndërveprimi me Aktorët e WEB.DEP & Forumi i Hapur Shqiptar

Ndërtimi / Forcimi i lidhjeve dhe bashkëpunimit me Shoqërinë Civile, Përfaqësuesit e Qeverisë Shqiptare, Akademikët, Studentët etj...


- Dhënia e ideve / shkëmbimi i experiences me iniciativa të tjera pjesëmarrje në Shqipëri
- Debat mbi rritjen e pjesëmarrjes, faktorët për sukses dhe çështje që lidhen me WEB.DEP
- Provimi real i produkteve të ATSH-WEB.DEP.

*“Nuk është vetëm leximi i lajmeve... Ky është dialogu publik për marrjen e vendimeve të së nesërme*



**Agjencitë e Lajmeve tashmë japin JO vetëm Lajmet POR edhe nisin procesin e dialogut publik.**





Merrni pjesë në dialogun publik dhe votoni nga kompjuteri juaj kudo që jeni.

## Votimet Elektronike

Pjesë e pandashme e projektit WEB.DEP janë dhe votimet elektronike apo sondazhet që secila nga agjencitë pjesëmarrëse në projekt publikon në portalin e saj duke i dhënë të gjithë vizitorëve të forumit mundësinë për të dhënë opinionin e tyre mbi çështjet e aktualitetit në një mënyrë mjaft të shpejtë dhe komode. Sigurisht kushdo mund të informohet mbi rezultatet e votimeve në çdo moment duke vizituar forumin.

Ndër temat e shtruar në forumin WEB.DEP të ATSH-së përmendim ndër më të votuarat:

**Pyetja: A mendoni se Shqipëria do të preket nga kriza financiare botërore ?**

Po – 58 Vota

Jo – 90 Vota

**Pyetja: Amendoni se gjeni shërbimime duhur në spitale ?**

Po – 6 Vota

Pjesërisht – 19 Vota

Jo – 17 Vota

**Pyetja: Cilët preferoni?**

Universitetet Publike – 15 Vota

Universitetet Private – 6 Vota

## Temat e diskutuara në Forum

Ndër temat më të shikuara apo diskutuara në forum mund të përmendim:

- LIBERALIZIMI I VIZAVE-BALLKANI PERËNDIMOR (Të Drejtat e Njeriut)  
*Diskutimet-6 Postime-21 Shikime-692*
- EMIGRACIONI SHQIPTAR. ANA TJETËR E MEDALJES (Ceshtje Sociale)  
*Diskutimet-2 Postime-16 Shikime-644*
- INFORMIMI PËR PROCESET INTEGRUESE, PRIORITET I MINISTRISË SË INTEGRIMIT PËR 2009 (Të Drejtat e Njeriut)  
*Diskutimet-3 Postime-15 Shikime-356*
- A KA FILLUAR TË NDIHET NË SHQIPËRI NDIKIMI I KRIZËS GLOBALE FINANCIARE (Ekonomi & Biznes)  
*Diskutimet-2 Postime-15 Shikime-181*
- PJESEMARRJA E GRUAS NË JETEN POLITIKE DHE EKONOMIKE TË VENDIT (Ekonomi & Biznes)  
*Diskutimet-6 Postime-12 Shikime-1213*
- MEDIA, SHOQËRIA CIVILE SË BASHKU NË LUFTËN KUNDËR KORRUPSIONIT (Ceshtje Sociale)  
*Diskutimet-1 Postime-13 Shikime-132*



WEB-DEP ATSH mundëson vendosjen e dialogut social direkt ndërmjet qytetarëve, organizatave qeveritare dhe atyre jo-qeveritare në një mjedis të perbashkët të iniciuar nga gazetarët

## Pjesmarrja Demokratike e Ballkanit Perëndimor

### Partnerët e Projektit:

Qendra Teknologjike e Athinës

Universiteti Teknik Kombëtar i Athinës

Bashkimi i Gazetarëve të Maqedonisë & Gazetave Ditore të Trakësë

Agjencia Telegrafike Shqiptare

Qendra Ndërkombëtare e Teledemokracisë – Universiteti Napier

Agjencia Maqedonase Informacionit

Agjencia Telegrafike Jugosllavisë Re

### E-Mail:

[symeri@ata.gov.al](mailto:symeri@ata.gov.al)

### Faqe Web :

<http://www.ata.gov.al/web-dep>



## Pjesmarrja dhe vizitorët e Forumit

Që nga publikimi i tij on-line forumi WEB.DEP i ATSH-së numëron mbi 130 përdorues të regjistruar përfaqësues të grupeve të ndryshëm të interesit. Përdoruesit e regjistruar janë të moshave nga më të ndryshmet ku spikasin me pjesmarrjen më të madhe ata të moshës 26-35 dhe 18-25 vjeç fakt ky që tregon interesimin e moshave të reja për iniciativa të kësaj tipi.

Për sa i përket angazhimit në forum të përdoruesve të regjistruar janë nxjerrë këto shifra:

Përdorues me 1 postim	- 18
Përdorues me 2-5 postime	- 15
Përdorues me mbi 10 postime	- 11

### 4 Forume janë të disponueshëm

- **Forumi ATSH**
- **Forumi MIA**
- **Forumi TANJUG**
- **Forumi Qendror në Anglisht**

## Prezantimi i WEB.DEP-ATSH në mediat shqiptare

Projekti WEB.DEP u prezantua tek publiku shqiptar në emisionin e përjavshëm ZIK-ZAK në TVSH I cili zgjati rreth 1 orë e 20 minuta duke bërë kështu një publicitet mjaft të mirë mbi këtë projekt dhe forumin WEB.DEP të ATSH-së.



Programi kishte një panel të përbërë nga gazetarë të BBC, AP dhe ATSH-së ku u fol për sfidat në transformimin e ATSH-së dhe ne pergjithesi te mediave publike. Z. Ymeri dhe Znj. Malja folën për rreth 15 minuta mbi projektin WEB.DEP, çfarë është ai dhe se si ai sjell qytetarët shqiptarë më afër procesit të vendimarrjes. Se si janë zgjedhur temat për diskutim dhe për avantazhet e përdorimit të shërbimeve të teknologjisë së informacionit në media. Gjithashtu u fol dhe për informacionin e marë nga përdoruesit e forumit dhe rezultatet e arritura në projekt.



ATC



NTUA



ESIEMTH



ATA



NAPIER - ITC



MIA



TANJUG